

UNMIK/REG/2001/21
20 shtator 2001

RREGULLORE NR. 2001/21

MBI DËSHMITARËT BASHKËPUNUES

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në përputhje me autorizimin që i është dhënë sipas Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren nr.1999/1 të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) të datës 25 korrik 1999 mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë dhe Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/24 të datës 12 dhjetor 1999 mbi Ligjin në Fuqi në Kosovë,

Duke marrë parasysh nevojën për pengimin dhe luftimin e krimit në Kosovë,

Me qëllim të krijimit të masave legislative për t'i nxitur dëshmitarët bashkëpunues në gjykatë,

Me anë të kësaj Rregullore shpall sa vijon:

Neni 1

Dëshmitar bashkëpunues

“Dëshmitar bashkëpunues” është personi për të cilin:

(a) prokurori publik dyshon se ka kryer një vepër penale, ose që është nën hetime të gjykatësit hetues apo është ngritur padi ndaj tij dhe padia nuk i është lexuar ende në seancën gjyqësore dhe

(b) pritettë ofrojë dëshmi në gjykatë e cila:

(i) ka mundësi të pengojë vepra të mëtejme penale të një personi tjetër;

(ii) ka mundësi të shpie në konstatimin e së vërtetës në një procedurë penale;

(iii) bëhet vullnetarisht me pajtim të plotë për të dëshmuar sinqerisht në gjykatë;

(iv) vlerësohet nga gjykata të jetë e vërtetë dhe e plotë dhe

(v) është e tillë që mund të shpie në ndjekjen e suksesshme penale të autorëve të tjerë të një veprë penale;

Neni 2

Urdhëri i dëshmitarit bashkëpunues

2.1 Prokurori publik mund t'i bëjë kërkesë me shkrim gjykatës për të lëshuar një urdhër për shpalljen e një personi dëshmitar bashkëpunues. Kërkesa duhet të përmbajë një deklaratë të veçantë mbi akuzat faktike të prokurorit, deklaratë e të cilit mund të përfshijë një kërkesë për mbajtjen sekrete të këtyre akuzave nga palët e tjera dhe nga përfaqësuesit e tyre ligjor me arsyet e një kërkesë të tillë. Gjykata, pas marrjes së kërkesës për fshehtësi nga prokurori, në çdo kohë mund të lëshojë një urdhër për fshehtësi lidhur me akuzat faktike që i përmban deklaratat.

2.2 Pas marrjes së kërkesës cildo nga gjyqëtarët e referuar në paragrafin 2.4 të këtij neni e dëgjon kërkesën në një seancë të mbyllur për publik. Prokurori publik dhe përfaqësuesi zyrtar i dëshmitarit që bashkëpunon mund të marrin pjesë në hetim për të vlerësuar besueshmërinë dhe për të siguruar plotësimin e kushteve të nenit 1. Deklaratat që i paraqiten gjykatës gjatë hetimit nuk mund të përdoren në procedurat penale kundër dëshmitarit bashkëpunues ose kundër ndonjë personi tjetër si prova për shpalljen e ndokujt fajtor.

2.3 Dispozitat që zbatohen për marrjen në pyetje të dëshmitarëve në hetimin preliminar, nenet 225 deri 235 inkluziv të Kodit mbi procedurën penale, zbatohen në mënyrë adekuate gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit bashkëpunues dhe deklaratat futet në procesverbal në përputhje me nenin 222 të dispozitave të Kodit mbi procedurën penale në fuqi.

2.4 Gjykatësi që lëshon urdhërin është ai gjykatës i cili është caktuar për hetim ose kryetari i gjykatës që është caktuar për seancën e dëshmitarit bashkëpunues. Nëse nuk ka kurrfarë hetimi apo padie kundër dëshmitarit bashkëpunues, atëherë gjykatësi i rrethit i cili është caktuar për hetim apo për kryesimin e procesit gjyqësor ku dëshmia e dëshmitarit do të dëgjohet e lëshon urdhërin. Përndryshe, çdo gjykatës i rrethit në Kosovë mund ta lëshojë urdhërin.

2.5 Pas përfundimit të shqyrtimit gjykatësi mund të lëshojë urdhërin për shpalljen e një personi si dëshmitar bashkëpunues dhe një urdhër i tillë duhet të theksojë shprehimisht se nuk do të fillohen apo vazhdoen kurrfarë procedurash gjyqësore kundër dëshmitarit bashkëpunues për veprën penale të specifikuar në atë urdhër dhe se kurrfarë dënimi nuk mund të shqiptohet për veprën e specifikuar penale.

2.6 Urdhri duhet t'i specifikojë veprat, duke përshkruar veprimet dhe kualifikimet e tyre për të cilën ndalimi për fillimin apo vazhdimin e procedurave gjyqësore është bërë, natyrën dhe përmbajtjen e bashkëpunimit të dëshmitarit që bashkëpunon dhe kushtet për revokimin e urdhrit.

2.7 Gjykatësi nuk mund të lëshojë një urdhër të tillë për dëshmitarin bashkëpunues për të cilin prokurori publik mendon apo është vërtetuar nga gjykatësi hetuas se aktualisht akuzohet me aktpadi apo kërkesë për zhvillimin e hetimit preliminar, se ka qenë organizator apo udhëheqës i një grupi prej dy apo më shumë njerëzve që kanë kryer veprën penale.

2.8 Urdhri nuk mund të pengojë fillimin apo vazhdimin e një procedure penale kundër një dëshmitari bashkëpunues për veprat e mëvonshme të kryera pas datës kur urdhri është lëshuar. Urdhri nuk mund të ndalojë fillimin ose vazhdimin e një procedure penale kundër një dëshmitari bashkëpunues për veprat penale të dënueshme me dhjetë apo me më shumë vite burgim.

Neni 3 Revokimi i urdhrit

3.1 Me kërkesë të prokurorit publik urdhrin mund ta revokojë një trup gjykues prej tre gjykatësve (paragrafi 6 i nenit 23 i Kodit të procedurës penale në fuqi) nëse vërtetohet se dëshmia e dëshmitarit bashkëpunues ka qenë e rrejshme në cilëndo pjesë përkatëse të saj dhe nëse dëshmitari bashkëpunues qëllimisht nuk e ka thënë të vërtetën e plotë.

3.2 Nëse dëshmitari bashkëpunues i cili kryen veprën penale të referuar në paragrafin 3.2 e tërheq dëshminë dhe dëshmon të vërtetën para mbarimit të dëshmisë së tij para gjykatës, pas dënimit gjohet deri në 1.000 DM ose dënohet deri në 90 ditë burgim, por edhe mund të lirohet nga akuza nëse gjyqi gjen rrethana lehtësuese.

3.4 Dëshmitarit bashkëpunues i tërhiqet vërejtja për pasojat e dhënies së dëshmisë së rrejshme në cilëndo pjesë përkatëse të saj ose nëse qëllimisht nuk e thotë të vërtetën e plotë para se atë ta dëgjojë gjykatësi konform nenit 2.2 dhe para se të dëshmojë në cilëndo seancë gjyqësore derisa ai është nën mbrojtjen e urdhërit. Një vërejtje të tillë e bën prokurori publik ose policia para se ai të dëshmojë para tyre dhe çdo dëshmi e tillë duhet të jetë në formë të shkruar në gjuhën e dëshmitarit bashkëpunues, e nënshkruar nga ai për të pranuar vërtetësinë e saj ose e incizuar në audio apo videokasetë, vërtetësia e së cilës vërtetohet nga ana e gjyqit.

3.5 Çdo shkelje e cilitdo urdhri të fshehtësisë të përcaktuar me nenin 2.1 të kësaj Rregulloreje që ndiqet penalisht nga prokurori publik sipas nenit 50 dhe nenit 50(2) të Kodit të procedurës penale në fuqi nuk konsiderohet mbrojtje.

Neni 4 Rregullat e dëshmisë dhe të procedurës

4.1 Të akuzuarit kundër të cilit dëshmitari bashkëpunues pritet të dëshmojë i dorëzohet një kopje e urdhërit para se i akuzuari të dalë në gjyq.

4.2 Trupi gjykues nuk mund ta shpallë asnjë person fajtor vetëm në bazë të dëshmisë së dhënë nga një dëshmitar bashkëpunues.

Neni 5 Falja apo zvogëlimi i dënimit të kryerësve të veprave penale të cilët para seancës gjyqësore nuk konsiderohen se janë dëshmitarë bashkëpunues.

5.1 Pas kërkesës së prokurorit publik, gjykata mund të vendosë që mos ta dënojë një kryerës të një veprë penale, i cili nuk është dëshmitar bashkëpunues, ose për t'ia zvogëluar dënimin sipas nenit 43 të Kodit të procedurës penale në fuqi, kur kryerësi i veprës penale bashkëpunon në mënyrë vullnetare dhe bashkëpunimi i tij apo i saj ka penguar vepra penale të

personave të tjerë, ose ka shpjer drejt ndjekjes së suksesshme penale të kryerësve të tjerë që kanë kryer një vepër penale.

5.2 Nëse kryerësi i veprës penale shpallet fajtor për një vepër penale për të cilën parashihet dënimi me dhjetë apo më shumë vjet burgim, gjykata nuk mund të heqë dorë apo ta pezullojë një vepër penale apo të refuzojë t'ia shqiptojë dënimin kryerësit të veprës penale për atë akuzë.

Neni 6

Ligji në fuqi

6.1 Kjo Rregullore shfuqizon çdo dispozitë tjetër të ligjit në fuqi që është në kundërshtim me të, duke përfshirë nenin 18 të Kodit të procedurës penale në fuqi.

6.2 Asgjë në këtë Rregullore nuk mund të ndikojë në kompetencat dhe përgjegjësinë e gjykatësit apo të prokurorit publik në kryerjen e detyrave të funksionit të tij apo të saj.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 20 shtator gusht 2001.

Neni 8

Dispozita kalimtare

Kjo Rregullore vlen gjithashtu edhe për veprat e kr yera penale si dhe për procedurat gjyqësore të filluara ndërmjet datës 10 qershor 1999 dhe datës së kësaj Rregulloreje.

Hans Haekkerup,
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm